



01 Nr. 635/25 Dt. 05.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 19 të Rregullores së MF-së 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit, për vitin 2025. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Jeton Jelliqi-kryesues, 2. Alban Susuri, 3. Fatlum Berisha, 4. Krenar Gaxholli, 5. Altin Krasniqi, 6. Alban Krasniqi, 7. Hasime Rashkaj, 8. Veron Aliu, 9. Zana Belloda, 10. Alban Hamzaj, 11. Agim Kukaj, 12. Azem Bilibani, 13. Samet Krasniqi, 14. Festim Shendeti, 15. Hamdi Bilurdagu, 16. Adelina Hoxhaj, 17. Mentor Ponik, anëtarë.
2. Ky Komision, për punën e bërë do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.
3. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do të bëjë inventarizimin e gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore konform Rregullores së MF-së 02/2013, për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore dhe akte tjera ligjore dhe nënligjore.
4. Ky Komision është organ i përkohshëm dhe mandati i tij përfundon me kryerjen e inventarizimit vjetor, për vitin 2025.
5. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
6. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, kryesuesi i Komisionit dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

